# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7748 E hënë 24 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Fjalimi i Ditës

Nga BEN ANDONI

## Pse po vonohet Reforma në Drejtësi?



Sikur skandalet e qeverisë së fundit shqiptare të ishin më të pakta, arroganca dhe ligjërimi i krerëve socialistë të ishte më i maturuar, atëherë gjithkush do të ishte më...

Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës

Nga GJERGJ BUXHUKU

## Revolta, që rrëzon ekonominë zyrtare



Pyetja e parë, që të shkon në mendje kur shikon kërkesat në daljet shumëditore të studentëve rrugëve të Shqipërisë është, se përse ndodhi pikërisht tani...

Vijon në faqen 20

KUSH JANE MINISTRAT ME TE RREZIKUAR DHE PRETENDENTET E PERFOLUR

# NDRYSHIMET NE QEVERI, THIRRET ASAMBLEJA E PS

Sot mblidhet kryesia e socialistëve për të caktuar axhendën. Tri ditë para vitit të ri, Rama pritet të deklarojë ndryshimet në kabinetin e tij




*(Në foto)* Gjatë një mbledhjeje të Asamblesë Kombëtare të PS-së

Në faqen 2










Forum/ Flasin drejtuesit: Cenojnë lirinë e shprehjes

## Gazetarët kundër paketës antishpifje: Cenohet media, e çon në autocensurë

PD: Ndryshime antikushtetuese, plani i Ramës për kontrollin e uebeve

Në mbledhjen e dy ditëve më parë me rektorë e dekanë, kryeministri i vendit, Edi Rama ka folur me tone të ashpra ndaj tyre e i ka akuzuar si fajtorë për gjendjen që solli protestën e mijëra studentëve. Në kundërpërgjigje të akuzave të kreut të qeverisë, rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni thekson se Rama nuk njeh...

Në faqet 4-5

EMRAT E DEKLARATA

### Filologjiku, 51 pedagogë kërkojnë shfuqizimin e ligjit për arsimin e lartë

Në faqen 7

ÇFARE DUHET TE DINI

### Projektligji i ri, lehtësirat për të emigruar në Gjermani me vizë pune

Në faqen 8

HISTORIA

### Át Gjon Shllaku, frati martir përballë diktaturës ekstreme që po vinte

Në faqen 19

DETAJET E OPERACIONIT

### Hashash e kokainë drejt Greqisë, kapen shqiptarët mes tyre dhe një grek

Në faqen 6

LISTA E PLOTE



### Zbardhen emrat e 700 punonjësve të shëndetësisë që hyjnë në provim

Në faqet 9-11

Mjeku kardiokirurg: 80% e rasteve vuajnë nga sëmundjet e venave të gjakut

## Sabian Memishaj: Ulcerat e këmbëve, mënyrat e trajtimit të tyre

*Ylli Merja: Problemet me stomakun, si t'i kuroni me gjethe mëllage*

Nga VOLTIZA DURO

Në rastet kur lëkura humb vazhdimësinë e saj dhe bakteret bien në kontakt me të, mund të shfaqen disa plagë të hapura në zonën e këmbës, e njohur ndryshe si ulçera e këmbëve. Në një intervistë për suplementin "Life Pages"






në 'Gazeta Shqiptare' kardiokirurgu Sabjan Memishaj tregon se rreth 80% e ulcerave të tilla shkaktohen nga sëmundjet e venave të gjakut, por thekson se edhe diabeti, apo artriti reumatoid mund të jenë faktorë të shfaqjes së këtyre plagëve. Mjeku...

Suplement

# ASAMBLEJA E PS-së

## NDRYSHIMET

Ministrat më të rrezikuar për t'u larguar janë Nikolla dhe Gjiknuri

# Kryeministri Rama thërret Asamblenë Kombëtare, gati ndryshimet në qeveri

## Sot mbahet mbledhja e kryesisë së PS-së

Ndërsa për shumicën e shqiptarëve ditët e fundit të këtij viti janë ditë festash, për anëtarët e qeverisë do jenë ditë ankthi. Kjo pasi kryeministri Edi Rama ka thirrur një mbledhje jashtë radhe të Asamblesë Kombëtare vetëm 3 ditë para Vitit të Ri, ku dhe pritet të bëjë publike dhe disa reforma të rëndësishme, përfshi edhe atë në kabinetin e tij qeveritar. Për këtë qëllim Partia Socialiste do të mbajë sot një mbledhje urgjente e Kryesisë, e cila në bazë të statutit duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë Kombëtare dhe të miratojë axhendën e diskutimeve dhe çështjeve që do të trajtohen në të. Burime nga Partia Socialiste kanë bërë me dije dje se Kryesia do të mblidhet sot në orën 09:00 dhe ajo do të drejtohet nga kryeministri, Edi Rama. Gjatë kësaj mbledhje pritet që Rama të informojë anëtarët e Kryesisë me vendimet që ka marrë, sidomos për t'iu përgjigjur nevojës për reagim që solli protesta e studentëve. Të njëjtat burime kanë bërë të ditur se Rama është treguar diskret deri më tani, pasi vendimet e tij i ka diskutuar vetëm me një rreth shumë të ngushtë, përfshi kryetarin e Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe kryetarin e grupit parlamentar, Taulant Balla. Gjithsesi gjatë mbledhjes së sotme Rama mësohet se do të parashtrojë vetëm nevojën për një reagim të menjëhershëm nga ana e mazhorancës, ndërsa hapat dhe vendimmarrjet konkrete pritet t'i bëjë të ditura vetëm në datën 28 dhjetor, gjatë mbledhjes së Asamblesë Kombëtare.

**NDRYSHIMET**

Nisur edhe nga situata e javëve të fundit, ministrat që rrezikojnë më shumë të largohen nga qeveria janë pikërisht ata që janë përballur me problematikat më të mëdha në sektorët që ministritë e tyre mbulojnë. Kështu, për shkak të protestës së studentëve më e rrezikuara nga këto ndryshime është ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla. Kjo jo vetëm për shkak se dorëheqja e saj është artikuluar shpesh herë edhe nga studentët, por edhe se duket se Rama ka humbur tashmë besimin se ajo mund të krijojë një raport komunikimi normal me studentët, çka duket se e bën të vështirë vijimin e detyrës së ministres. Ka qenë vetë Rama që e ka lënë të kuptohet këtë, teksa në gjithë takimet që ka zhvilluar me studentët gjatë këtyre ditëve nuk ka pranuar që të shoqërohet nga ministrja e Arsimit. Ai shpesh ka qenë i shoqëruar nga nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Arbian Mazniku, i cili shihet edhe si një kandidaturë e mundshme për të zëvendësuar Nikollën. Nga ana tjetër vetë Nikolla e ka lënë të kuptohet disa herë se është e gatshme të largohet nga ky pozicion, teksa në dy fjalimet e fundit të saja në Kuvend ka deklaruar se ishte gati të merrte përgjegjësitë që i takonin. Gjithashtu, një tjetër ministër që përflitet se rrezikon postin është edhe Damian Gjiknuri. Dhe largimin e tij e lidhin pikërisht me skandalin e kompanisë "DH Albania", e cila ndonëse e krijuar vetëm disa muaj më parë, nëpërmjet një dokumentacioni të falsifikuar, ka mundur që të sigurojë dy kontrata me vlerë 30 milionë dollarë. Edhe Gjinkuri në një nga daljet e fundit të tija për mediat deklaroi se ishte i gatshëm të merrte përgjegjësitë që i takonin në lidhje me këtë skandal. Një tjetër ministre që flitet se mund të ndryshojë është ajo e Kulturës, Mirela Kumbaro. Gjithsesi, mundësitë e largimit të Kumbaros në krahasim me dy ministrat e parë, janë më të vogla. Gjithashtu, nuk përjashtohet mundësia që Rama të mund të bëj dhe ndonjë rregullim të karakterit strukturor të qeverisë së tij, dhe kjo për të bërë më efektiv ndonjë dikaster të veçantë.




**FRESH**

Pjesë e kësaj reforme nuk do të jenë vetëm forumet drejtuese të partisë, por edhe organizatat pranë saj, siç është FRESH. Disa herë kryeministri Rama ka deklaruar gjatë këtyre ditëve se FRESH rezultoi gjatë debatit me studentët një organizatë shumë e dobët dhe inekzistente.

**REFORMA**

Burime nga PS bën me dije, gjithashtu, se kryeministri pritet të shpallë edhe një reformë në parti dhe që ka të bëj kryesisht me riorganizimin në prag të zgjedhjeve të ardhshme lokale. Pjesë e kësaj reforme nuk do të jenë vetëm forumet drejtuese të partisë, por edhe organizatat pranë saj, siç është FRESH. Disa herë kryeministri Rama ka deklaruar gjatë këtyre ditëve se FRESH rezultoi gjatë debatit me studentët një organizatë shumë e dobët dhe inekzistente.



## Rama pret policen Nuka: Krenar për ty, do të të japim ndihmë financiare



Pas kthimit nga Turqia ku iu nënshtrua një ndërhyrje të specializuar për transplantimin e gishtit të këputur gjatë protestës së banorëve të Astirit para Kuvendit të Shqipërisë, efektivja e Policisë së Shtetit, Ina Nuku është pritur në një takim të veçantë nga kryeministri, Edi Rama. Gjatë këtij takimi, ku i pranishëm ishte edhe ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj, kryeministri Edi Rama i shprehu asaj mirënjohjen për rolin që ajo, ashtu si shumë të rinj dhe të reja të tjera, jep në radhët e Policisë së Shtetit. Gjithashtu, ai theksoi se në shenjë solidariteti, por edhe falënderimi për kontributin që jep për shoqërinë shqiptare, qeveria do të miratojë edhe një vendim të veçantë për t'i akorduar një ndihmë financiare. "Ne jemi krenar për ty, pas një bisede me ministrin vendosëm që të japim një mbështetje financiare dhe morale për t'u rikuperuar qetësisht dhe të rintegrohesh pak nga pak, për të rifilluar dhe detyrën në fillim me një post më të lehtë", tha kryeministri Edi Rama. Ndërkohë që ministri i Brendshëm shtoi, gjithashtu, se efektivja e policisë shumë shpejt do të marrë dhe një detyrë më të lartë në radhët e forcave të policisë. "Ina Nuka e ka provuar veten se mund të përballojë një sfidë më të lartë në detyrë", - tha ministri Lleshaj. Ndërkohë gjatë bisedës, efektivja e forcave "Shqiponja" ka treguar edhe detajet nga operacioni i saj i vështirë në Turqi, duke falënderuar për këtë në mënyrë të veçantë kryeministrin për angazhimin e tij personal. "Është bërë implantimi dhe gjithçka ka shkuar sipas parashikimeve. Më kanë marrë një kockë në legen, dhe lëkurë në krah dhe këmbë për të formuar gishtin. Brenda gjashtë muajve do të kem ndjeshmërinë e gishtit ku është bërë impianti dhe më pas do të merrem me fizioterapi që të rikthehet funksioni i dorës. Në fillim mjekët nuk më thanë gjë, por më pas më treguan që, nëse do të isha vonuar edhe dy orë më shumë do të kisha humbur dorën pasi infektimi nga lëndët plasëse është shumë i shpejtë",- tregoi efektivja. Ndërkohë që kryeministri nga ana e tij bëri të ditur se për këtë operacion të vështirë është kujdesur edhe presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan, i cili sipas tij ishte kujdesur që të bëheshin të gjitha përpjekjet që gishti të rikuperohej. "U kujdes personalisht Presidenti Erdogan",- tregoi Rama.



## Familja Xhabafti në Vaqar me shtëpi të re, Rama: Rikthyem shpresën

Pak muaj më parë jeton te familja me 6 anëtarë e Euglen Xhabaftit në Vaqar jetonte në një barake dhe mjerim të plotë. Dje falë impenjimit direkt të kryeministrit, Edi Rama ajo ka mundur të marrë në dorëzim një shtëpi krejtësisht të re dhe të pajisur me të gjitha orenditë dhe elektro-shtëpiaket e nevojshme. Është vet kryeministri Edi Rama ai që ka publikuar dje një video në Facebook nga vizitat që kreu në shtëpinë e Euglen Xhabaftit në Vaqar, atë në datë 9 tetor ku dhe konstatuan gjendjen e mjerueshme dhe vizitën e djeshme ku dhe shpërndau disa dhurata për fëmijët e kësaj familje. "Me dritën e shpresës së rilindur në këtë familje, ju uroj një të diel të qetë", shkroi Rama në rrjetet sociale teksa publikonte videon e transformimit të shtëpisë së familjes Xhabafti.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




Banorët e Astirit kërkuan mbrëmë burg për ministrin Damian Gjiknuri

# Basha: Zhvendosën shtratin e lumit për fituar 60 mln euro

## "Gjëja më absurde që nga koha e Romës së Lashtë"

Banorët e Unazës së Re kanë dalë sërish mbrëmë për të 51 ditë me radhë në protestë për të kundërshtuar projektin e zgjerimit të Unazës së Re dhe prishjen e shtëpive të tyre. Me parullat 'Poshtë projekti', 'Burg për Gjiknurin', 'E duam Shqipërinë pa Edi Ramën', banorët njëzëri që kundërshtojnë këtë projekt thanë se nuk kërkojnë më dëmshpërblim, por anulim të të gjithë projektit të qeverisë, si dhe burg për ministrin e Energjisë dhe Transporteve, Damian Gjiknuri. Dorjon Protoduari, i cili u lirua pak ditë më parë nga burgu, i pranishëm në protestë kërkoi burg edhe për kreun e ARRSH, Afrim Qëndron, duke e cilësuar megaskandalin e bërë publik pak kohë më parë nga emisioni 'Të Paekspozuarit'', si kapje në tentativë për vjedhje. "Donin të vidhnin këtu dhe nuk ia dolën. Doli Afrim Qëndro te 'Opinioni' tha se paratë janë te Arka e Shtetit. O zotëri si vjedhja, si tentativa e vjedhjes dënohen njësoj në Kodin Penal",- u shpreh ai. Ndërkohë që banorët në protestën e tyre i mbështeti edhe kreu i opozitës, Lulzim Basha, i cili tha se në Tiranë po ndodh ajo që s'ka ndodhur që nga Roma e Lashtë, zhvendosja e lumit të Lanës.


Kreu i PD-së, Lulsim Basha me banorët e "AStirit"

Sipas liderit të së djathtës, kjo bëhet për të mos prekur kompleksin që do ndërtojë miku i Taulant Ballës me firmën e Ramës dhe Veliajt.

"Në vend që këta familjarë të gëzojnë Vitin e Ri, rrinë këtu në mes të rrugës duke protestuar. Dua të them që afera që nisi si korrupsion i pastër është provuar si aferë kriminale. Rama e Veliaj kanë ndryshuar planin urbanistik, të ndryshojnë rrjedhën e lumit të Lanës, që të mos cenohet asnjë centimetër i një kompleksi të një ish-trafikanti që do ndërtojë. Shteti funksionon si institucion hajdut. Të nxirret Plani Urbanistik i Tiranës i nënshkruar nga Rama e Veliaj, gjëja më absurde që nga koha e Romës së Lashtë. Ndërton aty ortaku i Taulant Ballës, me firmën e Ahmetaj, Ramës e Veliajt",-tha Basha.

Ndërkohë që më parë gjatë paradites së djeshme Partia Demokratike akuzoi sërish kryeministrin Edi Rama dhe kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj se në mënyrë të qëllimshme dhe për të favorizuar një biznes ndërtimi kanë devijuar shtratin e lumit të Lanës. Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, kreu i demokratëve, Lulzim Basha shkroi se kryeministri dhe kreu i Bashkisë së Tiranës kanë firmosur për ndryshimin e Planit Urbanistik të Tiranës për të zhvendosur shtratin e Lanës dhe për të prishur shtëpitë e mbi 200 familjeve tek Unaza e Re. Dhe kjo sipas tij me të vetmin qëllim për të favorizuar biznesmenin Edmond Bego, i akuzuar për trafik droge. "Rama dhe Veliaj firmosën për të zhvendosur shtratin e Lanës dhe për të prishur shtëpitë e mbi 200 familjeve! Këtë e bënë vetëm që t'i hapin rrugë projektit të mikut të tyre trafikant droge, ku do të pastrohen 60 milionë euro të krimit", - shkroi Basha. Pikërisht bashkëpunimi me elementë të tillë të botës së krimit, theksoi kryetari i opozitës është arsyeja që mazhoranca refuzoi vetingun në politikë. "Ndaj ata nuk e duan vetingun në politikë!", u shpreh Basha. Partia Demokratike prej disa ditësh ka denoncuar aferën korruptive që sipas saj fshihet pas projektit të Unazës së Madhe dhe që prek një pjesë të banorëve që kanë shtëpitë e tyre përgjatë rrjedhës së lumit Lana. Partia Demokratike publikoi të shtunën një material video të marrë nga sistemi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, ku sipas saj vërtetohet miratimi i fazës së parë të pajisjes me leje ndërtimi për Edmond Bego për të rrëzuar pretendimet e Bashkisë së Tiranës se nuk ka dhënë leje ndërtimi për biznesmenin Bego.

## Zyrtari i PPE: Lidhjet e politikës me krimin po pengojnë zhvillimin

Partia e djathta europiane mbështesin nismën e Partisë Demokratike për vetingun në politikë. I ftuar së bashku Andreas Lammel, me përfaqësuesin e Bundestagut gjerman të marrë pjesë në Akademinë Politike të të rinjve demokratë, Sekretari i Përgjithshëm i Partive Popullore Europiane, gjermani Christian Kremmer, u shpreh se vetingu i politikanëve në Shqipëri është një nevojë urgjente. Sipas tij kjo është e rëndësishme në kushtet kur sipas tij korrupsioni në vendin tonë dhe lidhjet e politikës me krimin po pengojnë zhvillimin. "Më lejoni të them qartë: pa ndarjen e pushteteve dhe drejtësi të pavarur nuk ka liri dhe demokraci funksionale. Korrupsioni dhe lidhjet midis krimit të organizuar dhe politikës janë vjedhje ndaj qytetarëve. Korrupsioni pengon investimet dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Prandaj, në rastin e Shqipërisë është logjike që vetingu të bëhet jo vetëm në drejtësi, por edhe për personat përgjegjës në politikë", - tha Christian Kremmer. Ai theksoi se kjo bëhet imediate për t'i kthyer të rinjve shpresën që ta ndërtojnë këtu të ardhmen e tyre dhe të mos kenë emigrimin si mundësine parë të zgjedhjes. "Ne e dimë se situata është keq dhe akoma më keq për të rinjtë. 1/3 nuk gjejnë punë në Shqipëri, shumë të tjerë largohen nga vendi. Të dashur miq, po luhet me të ardhmen tuaj! Mos lejoni që ky vend të trajtohet si pronë private e disa pakicave", shtoi më tej Kremmer. Ndërsa anëtari i Bundestagut, Andreas Lammel, e konsideroi Partinë Demokratike si alternativën e duhur qeverisëse. "Qeveria zgjidhet që të zhvillojë vendin, ta çojë atë përpara dhe në shërbim të qytetarëve, por qeveria e tanishme nuk e ka kuptuar këtë. Nëse doni të merrni fatin në dorë, punoni për të mundësuar që ju të qeverisni, sepse kohët janë të mira për opozitën. Për fat të keq, PD është akoma në opozitë, por vitin tjetër kjo mund të ndryshojë me zgjedhjet lokale" - tha deputeti gjerman i CDU-së, Andreas Lammel në Akademinë Politike 2018 të FRPD.



**DEPUTETI GJERMAN**
"Nëse doni të merrni fatin në dorë, punoni për të mundësuar që ju të qeverisni, sepse kohët janë të mira për opozitën. Për fat të keq, PD është akoma në opozitë, por vitin tjetër kjo mund të ndryshojë me zgjedhjet lokale" - tha deputeti gjerman i CDU-së

**DENONCIMI**
"Dua të them që afera që nisi si korrupsion i pastër është provuar si aferë kriminale. Rama e Veliaj kanë ndryshuar planin urbanistik, të ndryshojnë rrjedhën e lumit të Lanës, që të mos cenohet asnjë centimetër i një kompleksi të një ish-trafikanti që do ndërtojë"



## Vetingu, Bylykbashi: Rama i do kriminelët për të mbledhur vota

Demokratët e akuzojnë mazhorancën se nuk e do vetingun për shkak se nuk mund të ndahen nga kriminelët që i duan për të mbledhur vota në zgjedhje. Deputeti i PD, Oerd Bylykbashi nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale u shpreh se kryeministri Edi Rama nuk e do vetingun e politikanëve, pasi kriminelet i duhen për të mbledhur votat me para dhe presion. "Ja perse Edi Rama nuk e do vetingun e politikaneve. Atij kriminelët i duhen për të mbledhur votat me para dhe presion. Ja përse me 74 votat e tij në parlament refuzoi asistencën dhe Udhëzuesin e Komisionit të Venecias se si duhet bërë vetingu i politikanëve të lidhur me krimin. Ja perse Edi Rama përdor Kushtetutën si alibi për mbrojtjen që i bën këtyre politikaneve. Po njësoj, Edi Rama refuzonte Dekriminalizimin para zgjedhjeve lokale të 2015 duke mbrojtur Elvis Rroshin se përdhunimi në grup kishte qenë vetëm një "gabim rinie". Sot, sërish para zgjedhjeve, marrëdhënien me krimin përpiqet ta normalizojë, ta thjeshtojë dhe e quan marrëdhënie me elektoratin",-shkroi Bylykbashi.

DOMINUS
Njoftim Shitje ne Ankand
Shoqeria Permbarimore "Dominus" Rruga "Sami frasheri"pll "Titan", kati trete Tirane. cel 0692055122
Shitje ne ankand e e dyte te pasurise:Tokë Arë, Nr.Pasurie 104/16, ZK 3774, vol 3, faqe 141, e ndodhur në Vilë-Ballaj, Kavajë
Çmimi me të cilin fillon shitja e pasurisë në ankandin e dyte është 1.323.000 lekë (një miljon e treqind e njëzet e tre mijë)
Ankandi do te zhvillohet ne daten 25.12.2018, ora 16.00.

# PAKETA ANTISHPIFJE
## CENSURA

Vokshi ka denoncuar ndryshimet si përpjekje për t'i mbyllur gojën mediave kritike

# PD: Ndryshime antikushtetuese, plani i Ramës për kontrollin e uebeve

## "Kjo është paketa e censurës së plotë të medias"






Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

Partia Demokratike kundërshton me forcë paketën antishpifje të qeverisë, duke i konsideruar ndryshimet ligjore të paraqitura për këtë qëllim si një tentativë e pastër censure dhe kontrolli të medias përmes gjobave dhe presionit për mbylljen e tyre. Përmes deputetes, Albana Vokshi, e cila është njëkohësisht edhe kryetare e Komisionit parlamentar të Medias, selia blu ka denoncuar kryeministrin, Edi Rama se po tenton të vërë nën kontroll dhe t'u mbyllë gojën mediave dhe kryesisht portaleve online që nuk ndjekin politikën e qeverisë. "Dy projektligjet e qeverisë që kërcënojnë me mbyllje dhe me gjoba milionëshe portalet online janë plani i Edi Ramës për kufizimin e lirisë së medias në Shqipëri dhe kontrollin e plotë prej tij të çdo burimi informacioni në vend. Fuqizimi i portaleve dhe shndërrimi i tyre në një mjet të rëndësishëm për informimin e publikut në mënyrë të pavarur nga qeveria, po i rrezikon Edi Ramës investimin e tij më të madh 20-vjeçar në politikë: propagandën nëpërmjet kontrollit të medias kryesore tradicionale në vend",- tha Vokshi. Ajo shtoi se ndryshimet e hartuara nga qeveria për të ndërhyrë në ligjin e mediave audiovizive dhe atë për komunikimet elektronike, kanë për qëllim të godasin vetëm mediat që janë kritike ndaj qeverisë dhe nuk pajtohet sipas saj me aferat korruptive të kësaj mazhorance. "Me ndryshimet e propozuara, arkitekti i shpifjes dhe i mashtrimit, Edi Rama, ka urdhëruar ndërhyrjen në Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe në Ligjin për Median Audiovizive në mënyrë që të kontrollojë, gjobisë apo të mbyllë portalet kritike, ato që i zbulojnë aferat korruptive dhe lidhjet me bandat kriminale. Sipas gjuhës që Edi Rama përdor në projektligj "këto portale lajmesh nxisin vepra penale apo nuk janë në përputhje me moralin publik". Për këtë arsye duhen gjobitur deri në 10 milionë lekë ose duhen mbyllur përkohësisht apo përgjithmonë",-shtoi deputetja demokrate. Gjithashtu, ai theksoi se ndryshimet e propozuara, detyrojnë të gjitha portalet e informimin të regjistrohen pranë AKEP-it, një agjenci e kontrolluar nga qeveria, pavarësisht se mund të jenë të regjistruar në bazë të legjislacionit në fuqi, diku tjetër brenda apo jashtë Shqipërisë. Ajo theksoi se nëpërmjet shtimit të funksioneve të AMA-s dhe AKEP-it, Rama po kërkon që, ato të shndërrohen në institucionet që përgjojnë, gjobitin gazetarët dhe mbyllin mediat kritike online. Madje ajo ka theksuar se për të vënë në zbatim këtë paketë censure, mazhoranca po përpiqet që të vërë në kontroll dhe AMA-n duke shkarkuar përfaqësuesit e zgjedhur me propozim të partive opozitare, siç ishte dhe rasti i fundit i shkarkimit të Zylyftar Bregut. "Kjo paketë e censurës mediatike, është arsyeja që Rama po bën çdo përpjekje të kapë edhe Bordin e AMA-s duke shkarkuar në mënyrë antiligjore një nga anëtarët përfaqësues të opozitës në të. Asnjë nga këto parashikime antidemokratike nuk është model i ndonjë vendi të Bashkimit Europian. Kjo nuk është një paketë antishpifje. Kjo është paketa e censurës së plotë së medias. Partia Demokratike i konsideron dy projektligjet, antikushtetuese, që cenojnë rëndë lirinë e medias, lirinë e fjalës si dhe të drejtën kushtetuese për informim të qytetarëve",- u shpreh Vokshi.

**QËNDRIMI**

"Kjo nuk është një paketë antishpifje. Kjo është paketa e censurës së plotë të medias. Partia Demokratike i konsideron dy projektligjet, antikushtetuese, që cenojnë rëndë lirinë e medias, lirinë e fjalës, si dhe të drejtën kushtetuese për informim të qytetarëve",-u shpreh Vokshi.

## Qeveria: Ndryshimet janë bërë sipas modelit kroat

Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi të premten e shkuar një takim të hapur me aktorë dhe grupe të interesit që preken nga ndryshimet ligjore që përmban paketa antishpifje. Edhe gjatë kësaj tryeze të gjithë përfaqësuesit e medias që ishin të pranishëm rezultojnë të kenë shprehur shqetësimin se ndryshimet e paraqitura mund të çojnë median online drejt një censure dhe kontrolli të plotë nga ana e qeverisë. Kryetari i AMA-s, Gentian Sala pasi prezantoi nismën ligjore, ftoi të gjithë grupet e interesit të bëheshin pjesë e debatit, ndërsa theksoi se projektligji i propozuar është hartuar nga një grup pune ku kanë marrë pjesë përfaqësues të disa institucioneve KM, AKEP, AMA, MIE dhe Ministria e Drejtësisë. Gjatë kësaj mbledhje Elira Kokona, përfaqësuese e Këshillit të Ministrave vuri në vëmendje të pjesëmarrësve që përditësimi i ligjit




vjen në sinkron me ndryshimet e miratuara së fundmi në direktivën për shërbimet audiovizive. "Propozimet e paketës antishpifje janë rezultat i punës 1-2 mujore të grupit të punës. Ky grup pune ka analizuar legjislacionet e disa shteteve evropiane, të cilat rregullojnë këtë lloj media. Në draft janë dhënë disa propozime për masën e sanksioneve mbi shkeljet për të drejtën e përgjigjes, por vlerat e propozuara mund të jenë objekt rishikimi. Këto vlera janë propozuar në këtë masë duke patur parasysh shpejtësinë e qarkullimit të lajmit përmes kësaj teknologjie",-tha Kokona. Ilir Zela, Kryetari i AKEP, tha se është në të mirë të të gjithëve që instrumentet e kontrollit mbi faqet online, të cilat abuzojnë, të jenë në dorë të qytetarëve, ku mundësia e verifikimit dhe ankesës është një ndër to. Ndërsa përfaqësuesit e medias të pranishëm në këtë tryezë ngritën një sërë shqetësimesh nisur që nga gjobat, mbyllja e portaleve pa një vendim gjyqësor, si dhe censura që ai sjellë në media. Gjatë kësaj tryeze u bë e ditur gjatë hartimit të këtij projektligji, grupi i punës ka studiuar legjislacionet dhe modelet e shteteve të tjera, si Gjermania, Mali i Zi, Letonia dhe Kroacia dhe është konstatuar se rregullimi i përmbajtjes së publikimeve elektronike është normuar me ligj edhe në këto shtete dhe se në hartimin e këtij ligji, veçanërisht është marrë si model ligji kroat për mediat elektronike.

### MASAT QË MERREN NDAJ PORTALEVE

**1.** Për OSHPE-të e regjistruara në AKEP:
**a)** Pezullim/bllokim të aksesit ne internet, për një afat 24 orë, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer 3 (tre) kundërvajtje administrative të parashikuara nga ky ligj;
**b)** Pezullim/bllokim të aksesit në internet për një afat 7 (shtatë)-ditor, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se katër kundërvajtje administrative;
**c)** Pezullim/bllokim të aksesit në internet për një afat njëvjeçar, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se 5 (pesë) kundërvajtje administrative të parashikuara nga ky ligj.
**2.** Për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike që nuk janë të regjistruara në AKEP:
**a)** Bllokimin e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik ne territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat 24 orësh, nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se tre herë gjatë një viti kalendarik;
**b)** Bllokimin përfundimtar/mbylljen e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se katër herë gjatë një viti kalendarik.
**3.** Në rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, sipas neneve 33/1, 51/1 dhe 53/1, të këtij ligji, Këshilli i Ankesave vendos gjobë dhe detyrimin e OSHPE të publikoj formulën e ndjesës sipas vendimit përkatës të shkeljes së konstatuar.
**4.** Kundër vendimit të Këshillit të Ankesave mund të bëhet ankim sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 132, të këtij ligji. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.".
**5** Shkeljet e kryera nga OSHPE-të, kur nuk përbëjnë vepër penale janë kundërvajtje administrative dhe dënohen:
**a)** Me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë kur nuk respekton detyrimet e nenit 33/1 të këtij ligji;
**b)** Me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë kur nuk respekton vendimin e Këshillit të Ankesave apo të drejtën e përgjigjes, sipas nenit 53/1 të këtij ligji".



### Basha: Paketa është kontroll qeveritar dhe projekti më i paimagjinueshëm

# Gazetarët kundër paketës antishpifje: Çon median në autocensurë

## Likmeta: Cenojnë lirinë e shprehjes dhe atë të medias

Nisma e kryeministrit Edi Rama për të ndalur publikimin dhe përhapjen e lajmeve të pavërteta nëpërmjet regjistrimin dhe rregullim e medias online, rrezikon të kthehet në një goditje për lirinë e medias në vendin tonë dhe që do t'i orientojë gazetarët drejt autocensurës. Shumica e gazetarëve dhe botuesve të mediave online në vendin tonë e kundërshtojnë paketën antishpifje të hartuar nga qeveria, pasi sipas tyre ajo tenton t'i mbyllë gojën mediave kritike me qeverinë, duke i dhënë të drejtën AMA-s që të marrë masa administrative duke filluar që nga gjobat e papërballueshme për një media të tillë e deri te mbyllja fare e këtyre portaleve, pa i dhënë të drejtën e apelimit në gjykatë. Për redaktorin e BIRN-it në vendin tonë, Besar Likmeta ndryshimet e hartuara nga qeveria cenojnë thellë lirinë e shprehjes dhe atë të medias në Shqipëri, si dhe shkelin standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e medias. Sipas tij në qoftë se këto ndryshime do miratohen në mënyrën se si janë hartuar atëherë mediat online dhe gazetarët do të shtyhen drejt autocensurës. Ndërkohë që Anila Basha, drejtoreshë e "NewsBomb", një tjetër media online që vepron prej vitesh tashmë në Shqipëri, thekson se paketa e paraqitur nga qeveria "është ndërhyrje e pastër dhe e qartë, e dhunshme dhe e kompromentuar, censurë me vetëdije ndaj agjencive të ndryshme mediatike online". Sipas saj ndryshimet ligjore tentojnë të krijojnë shumë paqartësi për mënyrën sesi do të dallohet lajmi i vërtetë dhe se si do të përcaktohet nëse informacioni është trajtuar në mënyrë të paanshme, sikurse reket të vendos rregulla kjo paketë antishpifje. Jo vetëm kaq, por Basha evidenton si skandaloze dhënien e kompetencave për të vendosur gjoba deri në mbyllje të portaleve të ndryshme, nga një institucion si AMA që dominohet gjithmonë nga shumicat qeverisëse. Ajo që e bënë edhe më skandaloz këtë nismë sipas saj është mospërcaktimi i të drejtës për apelim të vendimeve të AMA-s në gjykatë. Ndërsa për pedagogun e informimit dhe kryeredaktorin e medias tjetër online "ALBEU", Emirjon Senja, projektligjet synojnë të ngrenë një "gjykatë të së vërtetës dhe moralit", e cila sipas tij rrezikon të kthehet në kamxhik të pushtetit sidomos ndaj mediave online. "Ligji i jep të drejtë kësaj "gjykate morali" të urdhërojë mbylljen e mediave online pa kaluar më parë nga sistemi gjyqësor. Edhe në pushtetet më autoritare seç kemi shembuj në rajonin tonë, është gjykata ajo që vendos mbylljen e një portali, ndalimin e aksesit në një adresë në rrjetet sociale, etj.", shprehet Senja. Për Besar Likmetën është e qartë, që nëpërmjet këtyre projektligjeve, kryeministri Edi Rama ka si qëllim të kontrollojnë përmbajtjen e publikimeve online, nëpërmjet kërcënimit të gjobave joproporcionale dhe një këshilli censure, i cili sipas tij nuk ka një të dytë në botën e lirë dhe demokratike.

**LIKMETA**
Nëpërmjet këtyre projektligjeve, kryeministri Edi Rama ka si qëllim të kontrollojnë përmbajtjen e publikimeve online, nëpërmjet kërcënimit të gjobave joproporcionale dhe një këshilli censure, i cili nuk ka një të dytë në botën e lirë dhe demokratike.

**BASHA**
Paketa antishpifje, është rasti më flagrant i ndërhyrjes së politikës në lirinë e medias. Është censurë e hapur, kontroll qeveritar, dhe projekti më i paimagjinueshëm, çka tejkalon edhe atë të burgosjes së gazetarëve. Qeveritë do të shkojnë e do të vijnë, parlamentet e këtij vendi po ashtu...

**SENJA**
Ligji synon te ngrejë një "gjykatë të së vërtetës dhe moralit", i cili rrezikon të kthehet në kamxhik të pushtetit sidomos ndaj mediave online, për kontrollin e të cilave është ndërhyre vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Madje, ligji i jep të drejt kësaj "gjykate morali" të urdhërojë mbylljen e mediave online pa kaluar më parë nga sistemi gjyqësor.






### BESAR LIKMETA (BIRN):

"Qeveria ka propozuar dy projektligje, për regjistrimin dhe rregullim e medias online, të cilat sipas opinionit tonë cenojnë thellë lirinë e shprehjes dhe atë të medias në Shqipëri, shkelin standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare dhe në qoftë se miratohen do t'i shtyjnë mediat online dhe gazetarët në autocensurë.

Është e qartë, që nëpërmjet këtyre projektligjeve, kryeministri Edi Rama ka si qëllim të kontrollojnë përmbajtjen e publikimeve online, nëpërmjet kërcënimit të gjobave joproporcionale dhe një këshilli censure, i cili nuk ka një të dytë në botën e lirë dhe demokratike. Këto projektligje janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe në shkelje të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut".



### ANILA BASHA (NEWSBOMB):

"Për projektligjin "Për mediat Audiovizive..."

Neni 33/1 që ka të bëjë me detyrimet e OSHPE-ve, është ndërhyrje e pastër dhe e qartë, e dhunshme dhe e kompromentuar, censurë me vetëdije ndaj agjencive të ndryshme mediatike online. Nuk e di nëse ndonjë nga parlamentarët apo qeveritarët që e kanë hartuar ligjin mund të japë përgjigje për pyetjen e mëposhtme:

Si e kontrollon organi kompetent që publikimet shfaqen në "mënyrë të vërtetë"? Kush mund të thotë dhe të përcaktojë se raportimet apo publikimet janë "të paanshme dhe objektive"? Pse dhe si do të vendosë organi kompetent për deklarata të paanshme nga partitë e ndryshme politike? Kjo pikë, jo vetëm cenon raportimin e lirë të medias, por tenton të censurojë dhe aktivitetin e forcave të ndryshme politike, një praktikë, që nuk haset në asnjë vend të botës.

Në pikën "d" qeveria tenton të na orientojë edhe produktin e lajmeve që prodhojmë. Nëse website që krijohet, ka në fokus të tij vetëm mbrojtjen e të drejtave të kafshëve dhe merr shtrirje më shumë se mbarëkombëtare, si duhet të "ofrohet për të gjithë përdoruesit njëlloj"? sepse mund të ndodhë që në këtë website, askush nuk do që të shkruaj për ngjarjet politike, apo për komunitetin LGBT...

Pika "ë" e përcaktimit të respektimit të "moralit publik" është ndoshta më qesharakja e vendosur. Sepse më kujtohen raste të parlamentarëve që në rrjetet sociale shkruajnë: "...ata të opozitës mendojnë për bythën e tyre". A është ky respektim i rregullave të moralit publik? A përbën kjo moral publik? Nëse për mediat ky është një detyrim, çfarë është për përdoruesit e zgjedhur me votë? Po fjala "mut", e përdorur jo më larg se në seancën e fundit parlamentare: Po fjalët, "i rrjedhur, i pjerdhur, kurvë, rruspie etj. etj." fjalë që rëndon përdoren në parlament, janë shfaqje të "Moralit Publik" dhe a e penalizojnë median?

Pika që ka të bëjë me penalizimet, është skandaloze.

Urdhërohet mbyllja e portaleve, kur AMA, një organ tërësisht politik, sipas interesave të momentit vendos për një, dy, tre a më shumë ankesa. Për të mbyllur median online për 24 orë, një ditë apo edhe një vit sipas oreksit apo pikëpamjeve të disa aktorëve rrogëtarë të shtetit për një media private. Projektligji, përveç një komisioni ankesash, nuk lejon asnjë fazë apelimi, procedurë kjo e panjohur më parë në botën demokratike.

Përfundimisht duhet thënë se:

Paketa antishpifje, është rasti më flagrant i ndërhyrjes së politikës në lirinë e medias. Eshtë censurë e hapur, kontroll qeveritar, dhe projekti më i paimagjinueshëm, çka tejkalon edhe atë të burgosjes së gazetarëve.

Qeveritë do të shkojnë e do të vijnë, parlamentet e këtij vendi po ashtu, e vetmja që do të mbijetojë, pavarësisht këtyre zhvillimeve është media. Edhe në vendet e tjera ku bëhen tentative për rastin e "FAKE-NEWS", si në Francë, ligjet janë kufizuar në fushata zgjedhore për të mos ndërhyrë në garë, por jo me shtrirjen e tij gjithë kohën.

Nuk mund të ketë liri të medias në vend, me një ndërhyrje të shumanshme si kjo që propozohet. Qeveria, parlamenti dhe çdo institucion shtetëror, duhet të kuptojë se në gjithë botën, gazetaria po ndryshon. Ka dalë nga klishetë standarde të lajmeve statike, për t'u adaptuar me kohën. Por politikanët shqiptarë që ecin me ritmin e breshkes, nuk mund të kuptojnë vrapimin e medias, ndaj kërkojnë me forma dhe mënyra të ndryshme të na vënë nën kontroll".



### EMIRJON SENJA (ALBEU):

"Ka një qasje të përgjithshme, madje edhe në perëndim për ta parë median, sidomos atë onlinë si një problem që duhet futur në "shina" dhe sigurisht Shqipëria nuk mund të shpëtonte nga këto simptoma. Media, ka mjaft mëkate në Shqipëri dhe angazhimi për t'i bërë gjërat më mirë është i mirëpritur, por nisur nga eksperienca e deritanishme, e një mungese kulture të medias së lirë në vend, si edhe të një tregu të prishur gjatë tri dekadave të fundit kur ne gazetarët kemi menduar se jemi të lirë, përmirësimi mund të vijë vetëm me vetërregullim, sepse qasjet për ta rregulluar këtë treg nga aktorë të jashtëm, siç janë në rastin konkret organet e përcaktuara prej ndryshimeve ligjore rrezikojnë të na sjellin në vëmendje periudha të errëta të raportit media-pushtet.

Ligji synon te ngrejë një "gjykatë të së vërtetës dhe moralit", i cili rrezikon të kthehet në kamxhik të pushtetit sidomos ndaj mediave online, për kontrollin e të cilave është ndërhyre vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Madje, ligji i jep të drejt kësaj "gjykate morali" të urdhërojë mbylljen e mediave online pa kaluar më parë nga sistemi gjyqësor. Edhe në pushtetet më autoritare, siç kemi shembuj në rajonin tonë, është gjykata ajo që vendos mbylljen e një portali, ndalimin e aksesit në një adresë në rrjetet sociale, etj. Për më tepër, duke parë edhe disbalancën në gjoba, duket se ka një qasje për të ruajtur monopolin e mediave audiovizive në raport me mediat online pasi nuk mund të shpjegohet ndryshe që gjoba ndaj një portali me një numër të kufizuar lexuesish që publikon një fake news të jetë disa herë më e madhe se sa një televizion që shihet nga një audiencë më e madhe".

Ngjarjet në Artë dhe Prevezë, identitetet mbeten sekret. Ndër të prangosurit dhe një femër

# Hashash e kokainë drejt Greqisë, kapen shqiptarët

## *Në grupin e të rinjve të arrestuar edhe një grek*

Kapen 60 kile marijuanë në kufirin me Greqinë. Policia e shtetit fqinj ka arrestuar tre shqiptarë edhe një shtetas grek për posedim dhe trafikim të lëndëve narkotike, origjina e së cilës është nga Shqipëria. Sipas të dhënave paraprake janë dy shqiptarët, një mashkull 30 vjeç dhe një femër 22 vjeç, ndërsa shtetasi grek është 29 vjeç. Për momentin nuk janë bërë të ditur identitetet e të arrestuarve. Tre të rinjtë kanë kaluar kufirin shqiptar dhe kanë qenë duke udhëtuar drejt Artës kur u ndaluan nga policia, e cila po sipas burimeve i ka ndjekur ata që nga kufiri. Kontrolli u bë në Amotopo pranë Artës ndërsa u gjetën dhe u sekuestruan 60 kg e 610 gram marijuanë dhe 6 celularë.





**KOKAINË**

Po ditën e diel në mëngjes një tjetër shqiptar është arrestuar nga policia greke në autobusin e Prevezës. 38-vjeçari identiteti i të cilit ende nuk dihet, është kapur me 3 kg 166 gram marijuanë dhe 30 gram kokaine. Atij iu sekuestruan dhe 165 euro e 2 celularë. Droga kishte si origjinë Shqipërinë.

64

**SASIA E KAPUR**

Vetëm më datë 23 dhjetor në shtetin fqinj, Greqi, janë kapur rreth 64 kilogram hashash dhe nje sasi kokaine prej 30 gram. Të akuzuarit për trafik janë 3 shqiptarë mes tyre dhe një femër, dhe një shtetas grek. Droga e kishte origjinën nga Shqipëria.

**SHKON ME SËPATË TE FQINJI, PRANGOSET**

Një 47-vjeçar shqiptar ka kërcënuar me sëpatë fqinjin e tij italian, në provincën e Aleksandrisë. Shqiptari ende i paindetifikuar sipas mediave italiane, pas një sherri banal me fqinjin e tij, një student italian, ka shkuar në shtëpinë e tij me sëpatë duke e kërcënuar. Menjëherë pas ngjarjes policia italiane ka proceduar penalisht shqiptarin ndërsa ka sekuestruar edhe sëpatën.


Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT
"AIRFIELD 2020" PROJECT
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked:
"CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**
**Administration Building**
**Rinas, Tirana**
**Albania**

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs.** on **11 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com


SHKURT

### U shtyp nga një makinë në Itali, identifikohet shqiptari

Selim Selmani, 58 vjeç është shqiptari, i cili humbi jetën gjatë aksidentit rrugor të ditës së shtunë në komunën Monteprandone, në Itali. Mediat italiane shkruajnë se 58-vjeçari, i cili u përplas për vdekje nga një makinë "Fiat" në rrugën "Scopa" të zonës industriale të Centobuchi, jetonte prej vitesh në shtetin italian me familjen e tij. Pas lajmit tronditës të vdekjes së tij, familjarët kanë vrapuar në vendin e aksidentit, duke këmbëngulur për të parë me çdo kusht trupin e tij, pavarësisht prezencës së policisë. Pas aksidentit tragjik, shërbimi i ambulancës shkoi menjëherë në vendngjarje për t'i dhënë ndihmë të aksidentuarit, por për fat të keq, shqiptari ndërroi jetë rreth 40 minuta pas përplasjes.




### Tragjike në Kretë, humb jetën foshnja 9-muajshe e shqiptarëve

**Thaçi:** Kam pasur një bisedë të shkëlqyer me këshilltarin për Sigurinë Kombëtare të Presidentit amerikan Donald Trump, ambasadorin John Bolton. Një takim ky që për mendimin tim është një mbështetje unike e plotë. Ishte konstatim i përbashkët se është momenti i duhur dhe historik, të cilin nuk duhet ta humbin Kosova dhe Serbia për arritjen e marrëveshjes përfundimtare që nënkupton njohjen përfundimtare reciproke, ndryshimi i Rezolutës 12/44, anëtarësimin e Kosovës në OKB. Edhe Shtëpia e Bardhë, administrata e presidentit Trump, ambasadori Bolton e theksoi shumë qartë se me zgjidhjen e problemeve ne rajonin e Ballkanit, duke përfshirë edhe përmbylljen e konfliktit një shekullor mes Kosovës dhe Serbisë, përmes një marrëveshje paqësore, edhe Evropa do jetë më e qetë dhe më e fortë. Ajo që mund të konstatoj është kjo, që Kosova do të koordinohet për të gjitha angazhimet që do të ketë në muajt e ardhshëm për të përmbyllur me sukses procesin e filluar për marrëveshjen historike të paqes e njohjes reciproke Kosovë-Serbi.

**Cili është roli i SHBA-ve?**

**Thaçi:** Roli i SHBA-së mendoj se do të jetë i pazëvendësueshëm dhe Kosova e unë personalisht do të jemi të koordinuar në çdo hap me Shtëpinë e Bardhë me administratën e presidentit Trump që do të hapte mundësinë e sigurt për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe në BE. Ky mendoj se ishte gjithashtu konstatimi përbashkët se ky është momenti që duhet të mobilizohen të gjithë, në mënyrë që marrëveshja të jetë sa më efektive, që të reflektojë paqe në rajon. Kështu Kosova do mund të ruajë karakterin e vet multietnik. Prandaj ishte konstatimi që duhet të arrihet marrëveshja, të arrihet njohja reciproke dhe kjo marrëveshje Kosovë-Serbi duhet të bartet edhe me heqjen e vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit dhe Kosova të përfitojë njohjen globale.

**Marrëveshja me Serbinë a nënkupton korrigjim kufijsh mes dy shtetesh?**

**Thaçi:** Marrëveshja do të jetë gjithëpërfshirëse dhe me një substancë të gjerë të shumë aspekteve apo çështjeve të hapura, të cilat do t'i negociojë ekipi negociator i Kosovës. Do të ishte në interes që në këtë proces të integrohet edhe opozita. Gjithçka do kalojë nëpërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, kështu që unë kam besim në ekipin negociator, të themeluar nga Kuvendi, me përfshirje të spektrit opozitar, në mënyrë që shteti ynë të jetë sa me unik dhe i qëndrueshëm në ballafaqimin me Serbinë. Nuk do të jetë e lehtë, por kam besim te ky ekip që do t'i kryejë punët mirë. Gjithashtu, do të shtoja që jam i lumtur për reformat në drejtësi. Prandaj mund të them që Kosova po shënon progres. Duhet të bashkëpunim i të gjithëve, pasi ne e dimë që në Ballkan ose ka lëvizje përpara për mirë ose lëvizje prapa për të keq, "status quo" nuk ka më. Prandaj është momenti për vendim, është momenti për të ecur përpara. SHBA mbështet plotësisht pavarësinë e Kosovës, sjelljen e njohjeve të reja, anëtarësimin e Kosovës në organizata të tjera ndërkombëtare dhe njëkohësisht mbështesin plotësisht sovranitetin tonë si shtet.

**Ju kishit një debat të jashtëzakonshëm në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i thirrur ky nga Rusia me kërkesën e Serbisë. Çfarë mendoni se e ka "nxitur" Serbinë për të kërkuar me anë të Rusisë aleate një debat të tillë të ashtuquajtur 'i jashtëzakonshëm'?**

**Thaçi:** Po ashtu si edhe ju pyesni - realisht ishte një seancë e jashtëzakonshme në një moment dhe kohë të zakonshme. Pra, nuk kishim të bënim me një situatë të tillë si edhe pretendon Rusia me kërkesën e Serbisë për të thirrur një seancë të tillë. Dihet se shkas u bë vendimi për të transformuar FSK në Ushtrinë e Kosovës, një vendim ky më se normal i marrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në kushte më se normale nga të zgjedhurit e popullit të Kosovës. Serbia është zëmëruar me këtë rast, por qytetarët serbë të Kosovës mendojnë se Jo!. Në anën tjetër, themelimi i Ushtrisë së Kosovës ka mbështetjen e plotë dhe masive të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mbështetje unike të politikës kosovare. Andaj gjej rastin edhe një herë të falënderoj të gjithë për këtë mbështetje kaq të madhe. Por njëherit edhe të shteteve anëtarë të Këshillit të Sigurimit, vendet e Bashkimit Evropian që e kanë mbështetur dhe e mbështetën pa ekuivoke edhe sot themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Tanimë pas këtij debati ose seance të mbajtur krejt të panevojshme, me kërkesën e Serbisë nga Rusia, mund të themi se edhe ky debat iku dhe shteroi. Ushtria e Kosovës do të ecë vetëm përpara - s'ka kthim mbrapa më.

**Në këto kushte për sa flisni ju, a mendoni se të njëjtën gjë ka për të bërë edhe Beogradi, që pas kësaj seance të vazhdojnë dialogun në Bruksel?**

**Thaçi:** Definitivisht, në bisedimet tona nuk ka asnjë alternativë tjetër. Dialogu duhet të vazhdojë dhe të arrijmë në një marrëveshje paqësore përfundimtare që sipas meje do të thotë njohjen pa kushte të Kosovës nga Serbia; që do të thotë njohjen e njëratjetrës si dy vende fqinje dhe sovrane. Dhe kështu do të përshpejtojmë rrugën e Kosovës drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Edhe për Serbinë natyrisht është e natyrshme rruga e saj evropiane, të cilën ajo pretendon se e ka nisur. Ne nuk duam urrejtje, nuk duam as hakmarrje, por duam mirëkuptim dhe paqe mes njëri tjetrit. Dhe këto mendojmë se i arrijmë vetëm me një përmbyllje finale të marrëveshjeve mes vetit përmes një procesi.

**Hashim Thaçi:**

"Marrëveshja do të jetë gjithëpërfshirëse dhe me një substancë të gjerë të shumë aspekteve apo çështjeve të hapura, të cilat do t'i negociojë ekipi negociator i Kosovës",-ka thënë presidenti Thaçi.

**Ministri i Jashtëm serb:**
Nëse përfshihet SHBA në dialog, ne thërrasim Rusinë

Ministri i Brendshëm i Serbisë, Ivica Daçiç ka thënë se nëse në dialogun Kosovë-Serbi përfshihen SHBA-të, atëherë Beogradi do të thërrasë Rusinë. "Nëse ka ndryshuar forma e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, në atë mënyrë që në dialog të përfshihet edhe Amerika, atëherë pala serbe duhet të telefonojë Federatën Ruse për të marrë pjesë",-ka thënë Daçiç për një portal serb, shkruan 'B92'. Media serbe shkruan, gjithashtu, se autoritetet e Kosovës kanë bërë të ditur se që nga janari e deri në fund të pranverës, dialogu mes Beogradit dhe Prishtinë do të hyjë në një fazë të re në të cilën do të përfshihet edhe Uashingtoni. Daçiç theksoi se Beogradi do të jetë plotësisht i përkushtuar për dialog, vetëm atëherë kur Kosova të heqë taksën.

## TRONDITET INDONEZIA, GODITET NGA CUNAMI ME QINDRA TË VDEKUR

**Në Indonezi kanë humbur jetën të paktën 222 persona dhe 745 të tjerë janë plagosur pasi cunami goditi bregun e Sunda Strait. BBC raporton se qindra ndërtesa janë shkatërruar. Agjencia e Menaxhimit të Fatkeqësive thotë se shkaku i mundshëm i cunamit mund të jenë rrëshqitjet e dheut në det pas shpërthimit të vullkanit Krakatoa. Autoritetet vendase kanë paralajmëruar se numri i viktimave mund të rritet. Në mediat sociale është publikuar edhe një video ku duken momente nga goditja e cunamit. Tsunami që goditi mbrëmjen e të shtunës Indonezinë, përveç bilancit tragjik, ka shkaktuar një tragjedi të vërtetë gjatë koncertit të një bande të famshme lokale.**



FOTOLAJM

# I lumi Át Gjon Shllaku, frati martir përballë diktaturës që vinte

Prof. dr. Aljula Jubani



Në njërin prej mëngjeseve të shumta, që lindnin të përgjakura, Zalli i Kirit oshtiu nga breshëritë e plumbave që godisnin për t'u marrë jetën përsëri disa burrave, të martirizuar në tortura ekstreme. Ishte 4 marsi i vitit 1946, kur Át Gjon Shllaku, së bashku me Át Daniel Dajanin, Át Giovanni Faustin, seminaristin Mark Çuni, të rinjtë Qerim Sadiku e Gjelosh Lulashi do të kalonin në amshim, ndërkohë që trupat e tyre i mbuluan me hekurishte në buzë të lumit. Për dekada të tëra emrat e tyre ia fshehën historisë. Por çka i bën dëm edhe sot kombit, është se ia fshehën edhe kontributin e tyre, ashtu si veprën e tij "Histori e filozofisë", e cila ishte në proces shtypi dhe u zhduk kushedi se ku. Në këtë mënyrë, si në historitë biblike, njerëzit do të rendnin drejt idhujve të rremë, do të përfundonin të përhumbur në tempujt e përmbysur.

Át Gjon Shllaku lindi në Shkodër, me mbrojtës Shën Kollin, emrin e të cilit i dhanë prindërit. Nxënës i shkëlqyer i Kolegjit Françeskan, student i teologjisë, filozofisë, historisë, madje brilant edhe në shkencat ekzakte, u diplomua në Holandë dhe mbrojti doktoraturën, me rezultate të shkëlqyera, në Francë. U shugurua meshtar, më 15 mars 1931, dhe zgjodhi emrin Gjon, duke thirrur ndihmën e Shën Gjonit. U rikthye në vendlindje për të dhënë gjithçka zotëronte, me frymëzimin fetar dhe patriotik të etërve françeskanë "Fé e Atdhé". Át Gjoni na kujton se martirizimi i shqiptarëve për komb e atdhe shtyhet thellë në histori e në çdo moment të rëndësishëm françeskanët janë aty. "Franciskant i falen Shqypnís Poetin e fisit, të racës. Flamurtarë desin, flamurtarë zhduken; por flamurtarët françiskan Shqypnín edhë në vorr do t'a permendin. Kan me e permendë edhè kur vorri të jetë ndo'i muranë e stolisun."

Këtë vit, Shtypshkronja Françeskane sjell në një botim pjesën më të madhe të artikujve të Át Gjon Shllakut, në veprën "Shqyptari - Frati - Shqypnia". Át Gjonin mund ta njohim në mënyrë të drejtpërdrejtë nga leximi i shkrimeve të tij, por historia e jetës së tij na ndihmon të kuptojmë më mirë se nga i buron poliedrizmi i shfaqur në artikujt e tij, se nga vjen guximi i transmetuar në publicistikën e tij dhe qëndrimi i vendosur për çështje të rëndësishme të kombit dhe të religjionit, që hapte rrugën me ndërgjegje drejt kalvarit të martirizimit të tij.

Janë me mjaft vlerë shkrimet e tij, ku shihet interesi për çështje të zhvillimit të ekonomisë, edhe të vendeve mjaft larg Shqipërisë; me tema të rëndësishme të filozofisë, të politikës, të kulturës. Jo rastësisht, objekt i këtyre shkrimeve bëhen edhe zhvillimet ekonomike në Japoninë dhe Rusinë e kohës. Lexuesi gjendet përpara një shpërfaqjeje të hollësishme, me të dhëna të sakta, mbi të ardhurat vjetore, transportet, depozitat bankare. Shqyrtimi i këtyre zhvillimeve të drejton në analizën e sistemeve politike dhe filozofisë prej së cilës udhëhiqeshin qeveritë e tyre. "Lenini, nuk pat durim me pritë evolucjonin e kadalëshëm të profetizuem prej Karl Marksit, por me at zhenín e vet satanike krijoi nji rrevolucjon artistik, neper të cillin më nji kohë fare të shkurtë mrûni me puntorí, bulqë e ushtri shtetin komunist. .... Në nji pikë me rândësí veç kishim me dashtë me hjekë vrejtjen e lexuesave t'onë d.m.th. se çë rrjedhë fatale mundet me perftue në jeten e popullit e të kombit kúr nji çetë kësi fanatikësh, pá marrë në dorë faktorët tjerët psyhologjikë të nji socjologjije të shndoshtë, luen harushë me tagret e të drejtat má shêjte të popullit." Nuk duhet një analizë e thellë për të parë se si në një lëmsh deklaratash bombastike, fshihet një sektarizëm i thartë me synim sulmin, si një manovër e rafinuar oportunizmi, për të mbërritur në meskinitetin e interesave vetjake apo klanore.

Át Gjoni e thekson në çdo shkrim të tijin se idetë dhe mendimi janë parësore në shoqërinë njerëzore, sepse pavarësisht fushës së dijes në të cilën kontribuon dikush " ... aj do të dalë në nji formylë, sido qi kjoftë, positive a negative, e cilla shkapercen rrethin e lamit të vet e kalon në filozofí".

Me shumë prej artikujve, ai e shtyn lexuesin të reflektojë mbi ekzistencën e njeriut si qenie njerëzore, që qëndron edhe në qendër të absolutit metafizik, i cili vjen edhe më real se realja nën dritën e pyetjes themelore "Pse ásht?". Ashtu si Shën Agustini, i cili na kujton se njohja e Zotit nuk mund të arrihet përveçse nëpërmjet njohjes së vetvetes.

Po të jesh shqiptar, çfarë do të thotë në këtë "pluralitet të kênëve"? Át Gjoni na vë përballë historinë, të sotmen, çfarë kemi humbur e çfarë kemi mbrojtur dhe çfarë duhet vlerësuar.

"Na, breznija e sodshme, qi i kemi jetue veç porsá kohët e mjegullta të lëvisëjeve t'independencës s'onë komtare, nuk diejëm me e çmue sa duehet randsín qi ka per né me pasë per atdhé Shqypnín; lirija çmohet vetem atëherë kur njeri gjindet a bjen në robnín e të huejit. Prandej na kemi pse me kênë fare kondend per ketë cung votre, në të cillin pushon shqyptari zot i lirë në shpi të vet." E ardhmja e Shqipërisë do të jetë ajo që përgatisim sot, duke pranuar përgjegjësitë tona dhe domosdoshmërinë e një vullneti të fortë për të formësuar ndjesitë e nacionalizmit të vërtetë e për ta orientuar shtetin shqiptar drejt "oksidentalizmit". Një intelektual duhet të jetë mendjehapur për të njohur e për ta shtrirë larg mendimin "Shpirt i kufizuem - esprit borné - âsht e shamja mâ e madhja qi mund t'i bâhet nji mêndimtarit." Shpesh zëri i tij ngjan me atë të Platonit në apologjinë e Sokratit.

Shpirt i lirë e kurajoz, një mendje e ndriçuar si e tij, një personalitet dinjitoz dhe i vendosur, si Át Gjon Shllaku, sjell, nëpërmjet disa shkrimeve polemizuese, edhe modelin e debatit dhe të të kundërshtuarit me argument. Si një përshkues i rrugës së filozofisë, ai i përmbahet parimit: "Affirmantis est probare. Vetem asercjoni a se thanja nuk âsht nji prov?.".

Por, ishte duke nisur një kohë e re për kombin dhe vendin. Át Gjoni e dinte mirë çfarë rreziku mund të paraqiste filozofia e re që po përhapej vrullshëm në fundin e Luftës së Dytë Botërore. Konceptet e relativizuara në "Etikën" e Spinozës, Át Gjoni i çon përmes përsiatjesh dhe analizash filozofike drejt një traktati për shekullin ku po jetonte dhe për një erë të re që po zhurmonte mbi vendet përreth e në Shqipëri, komunizmin. "Tash mâ se nji gjysë shekulli Marx e Nietzsche galvanizojn turmat. Ngadhnimi i racjonalizmit abstrakt perftoi si reakcjon dý rrymë, qi, sado në kundershtim ndermjet vetit, perkojn shfronzimin e plotë t'arrsyes."

Kësaj teme i kushton disa shkrime me objekt analizën e filozofisë komuniste, si: "Çashtje filozofike"; "Problemi i njohtëjes"; "Shka âsht komunizmi?"; "Karakteri religjoz i komunizmit"; "Magna charta e shekullit të sotshem". Át Gjoni e dinte qysh prej fillimi se çfarë ishte kjo filozofi, por ai nxit analizën dhe reflektimin për mënyrën si lindi dhe çfarë marrëdhënieje ka me utopinë embrionale dhe filozofët prej të cilëve u frymëzua. Ai ishte student i Jacques Maritain, ishte një njohës i mirë i Marx-it, Feuerbach-ut, Bergson-it, Hegel-it, Fichte-s, Gentille-s, ndaj dhe e shihte qartë se kjo filozofi materialiste (apo edhe ajo e idealizmit absolut që shpërtheu në panteizëm) po shndërrohej në një religjion me dogmë e moral, e me kryepriftin e saj - sekretarin e përgjithshëm të partisë. Féja do të ishte rrezik për realizimin e idealit komunist, sepse ajo frymëzon bashkëjetesën mes njerëzve të të gjitha klasave shoqërore, kurse komunizmi nxit, para së gjithash, luftën e klasave."Diviniteti a se hyjnija e ré para së cillës do të ngjujojn popujt nuk âsht kurrgjâ tjeter veç Proletarjati a se shoqnija socjaliste. Kurrnji akt i tij, kurrnji mêndim i tij, n'asnji moment së do t'i terhiqet kavís shêjte qi e galvanizon e e sht?n tanë jeten e tij, qi i drejton gjurmët e tija e i vien si normë morale per aktet e jetës së tij."

Sipas Át Gjon Shllakut, ka disa besime, të cilat nuk kanë kurrfarë dinamizmi në vetvete e nuk kanë për qëllim ekspansionin; ndërsa disa të tjera, prodhojnë pa ndalur legjione apostujsh e kërkojnë t'i mbledhin të gjithë njerëzit në nji botëkuptim të vetëm. "Komunizmi hîn në ketë kategorín e dytë". Qysh në fillim, marksistët e parë, Marksi e Engelsi, morën një fytyrë profetësh e predikuesish të një kryqëzate bamirëse për njerëzimin. Kur u instalua "definitivisht në Rusí, ndrroi fëtyrë krejt: mystika e proletarjatit ndeshi idén e mesjanizmit", e cila e gjeti objektin e vet kur leninizmi filloi të përhapë idenë e dashurisë dhe të drejtësisë së tij shoqërore.

Ky ishte modeli i drejtësisë, i vendosur edhe në Shqipëri, që i çoi në vëllavrasje shqiptarët, në mënyrën më të pamëshirshme e sistematike: "U bâ katil fëmija pesëmbëdhetëvjeçár, u bâ katil plaku me thija... Fjalë e ditës: vdekje e luftë! Vdekje okupatorit, trathtarëvet, kuinsligavet, kompromisaxhijvet, kolonës së pesët, komunistavet e antikomunistavet etj. Gjithkah të shitun, gjithkah trathtarë. Pushka e rrokun me pretekst, të luftohet okupatori, po sielet kundra njani-tjetrit. E gjaku shkon rrëkajë...".

Opinioni i Ditës

# Revolta, që rrëzon ekonominë zyrtare

Nga Gjergj Buxhuku

*(vijon nga faqja 1)*



... Përtej hipotezave të çfarëdo tipi, politike ose jo, të vendit apo të huaja, klanore ose partiake, se cilët mund të kenë nxitur ose se kush mund të përfitojë nga protesta e tyre sot ose nesër, një fakt është i pamohueshëm. Studentët në masë dërrmuese janë ngritur masivisht pikërisht sot dhe jo p.sh para 3, 5 ose 10 vjetësh. Çfarë ka ndodhur?

Shpjegimi i vetëm i pyetjes së mësipërme nuk është i vështirë të gjendet. Janë ngritur në revoltë dhe janë kaq këmbëngulës pikërisht sot, sepse gjendja ekonomike e familjeve, prindërve dhe vetë atyre ka rënë aq poshtë, sa nuk u ka lënë rrugëzgjidhje tjetër. Përveç daljes në rrugë. Ose thënë më qartë. Prindërit janë të detyruar të bëjnë zgjidhjen e fundit të vështirë dhe të dhimbshme të nxjerrin fëmijët e tyre në rrugë, sepse nuk mund të përballojnë dot më mbështetjen financiare te vazhdimit të shkollës. E vërteta e pamohueshme është, se në rrugë sot nëpërmjet studentëve janë edhe prindërit e tyre. Në kushte të tilla, kemi të bëjmë me revolta të shoqërisë në tërësi, të shprehur në pikën më të ndjeshme dhe më të mundshme të shpërthimit në kushtet e zbrazjes rrëqethëse të popullsisë shqiptare. Studentët.

Arsyetimi i mësipërm vë në pikëpyetje të madhe vërtetësinë e shifrave zyrtare të rritjes ekonomike të vendit. Sipas të dhënave qeveritare pretendohet, se vendi të paktën në tre vitet e fundit ka patur një rritje ekonomike mesatare prej 3% të PBB. Një rritje e tillë duhet të kishte një përmirësim të nivelit të jetesës, ose të paktën nuk duhet të kishte varfërim. Por, revolta me thelb varfërinë, flet ndryshe.

Dy janë mundësitë. Ose shifrat qeveritare janë të pasakta dhe Shqipëria faktikisht ka qenë dhe është në recesion ekonomik përtej shifrave zyrtare, ose rritja ekonomike e Shqipërisë është e tillë, që thellon dukshëm pabarazinë shoqërore. Ose dhe të dy raste së bashku. Në të gjitha rastet kemi të pranishme as më pak e as më shumë, dështim të qeverisjes dhe rënie të një sistemi ekonomik të ndërtuar në pothuaj 30 vjet. Një sistem ekonomik, që në rastin më të mirë prodhon rritje, që përfundon në pasuri vetëm për një grusht njerëzish. Dhe në rastin më të mundshëm, që vazhdon të rrisë pasurinë e një grushti njerëzish edhe në kushtet e rënies ekonomike! Dhe kjo e fundit si përfundim rrezikon të ketë, ose rindërtimin thelbësor ligjor të sistemit ekonomiko-politik në fuqi, ose vendosjen e diktaturës. Diktaturë të hapur ose të fshehtë nuk ka shumë rëndësi.



Opinioni i Ditës

# Pse po vonohet Reforma në Drejtësi?

Nga Ben Andoni

*(vijon nga faqja 1)*



...i maturuar, atëherë gjithkush do të ishte më i interesuar për të mësuar fatin e Reformës në Drejtësi. Por, kjo nuk ndodh, pasi për ditë qeveria e Ramës zhytet ndër akuza që po provohen, kurse ligjërimi i krerëve prej kryeministrit deri poshtë është dhe mbetet tejet agresiv. Duke i shtuar edhe protestën e studentëve, organizimin e të cilës ende sot nuk po e kupton askush, atëherë Reforma po mbetet krejt e harruar. Shkundja e vetme ishte pak ditë më parë, kur Gent Ibrahimi u zgjodh kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe kumtoi se tashmë rruga për zgjedhjen e kryeprokurorit të ri është e hapur. Po a mund të kursehej disi zgjedhja e tij? Jo. Pa mohuar cilësitë e kryetarit të ri të KLP-së, kandidatura kishte probleme pasi tre herë ishte kthyer pas nga Gjykata e Strasburgut, për të qenë gjyqtar në të. A paraqet kjo ndonjë problem? Mund të themi jo për qeverisjen, përderisa e mundësoi kandidaturën, por asesi për opozitën që gjeti një mal me akuza ndaj tij, duke e konfuzuar krejt publikun dhe vetë arritjet dhe problemet për Reformën.

Duhet të kujtojmë se plot një vit më parë, shorti i muajit dhjetor 2017, përcaktoi 57 subjektet e listës së përparësisë. Qëllimi: nevoja për të avancuar procesin e ngritjes së organeve të
drejtësisë dhe për të përshpejtuar fillimin e ngritjes së Gjykatave KKKO dhe SPAK. Një vit më vonë, finalizimi i rivlerësimit për subjektet e kësaj liste nuk ka përfunduar ende. Ndoshta qëllimi për të gjetur deficiencën, mbetej një nga objektivat kryesorë për t'u përcaktuar te Raporti i Monitorimit mbi Ecurinë e Procesit për Ngritjen e SPAK (Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) dhe Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, material i përgatitur prej QSDG. Për hir të së vërtetës, pakkush kishte dyshim që "Reforma në Drejtësi" do të ndryshonte shumë gjëra, por deri më tani në publik besohet se thjesht po lëviz një drejtësi e korruptuar dhe po ia lë vendin një tjetre të kapur krejt politikisht.

Sfida më e madhe e Reformës në Drejtësi ishte dhe mbetet krijimi i Institucioneve, që do ta menaxhonin dhe zgjedhja e individëve të cilët do e drejtonin dhe do i përbënin institucionet e saj. Ato janë Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Gjykata e Apelit, si dhe nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Për ata që nuk e dinë: SPAK do të jetë një strukturë, e cila përbëhet nga dy komponentë: Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Prokuroria e Posaçme ka për mision të ushtrojë ndjekjen penale dhe ta përfaqësojë akuzën në të tre nivelet e gjyqësorit (Gjykatën e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatën e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe Gjykatën e Lartë). Kurse Byroja Kombëtare e Hetimit, e cila vepron vetëm nën drejtimin e Prokurorisë së Posaçme, do të jetë një strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, e cila do hetojë veprat penale në juridiksionin penal të kësaj Prokurorie. Veçse, paçka arritjeve, " edhe pse ngritja e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të Reformës në Drejtësi, proceset kanë hasur në pengesa, të cilat kanë bërë që të tejkalohen afatet e parashikuara në ligj për ngritjen dhe vënien në funksion të tyre. Sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, brenda 300 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, konkretisht në fund të muajit gusht 2017, parashikohet që Prokuroria e Posaçme të kishte filluar ushtrimin e funksioneve të ndjekjes penale nëpërmjet kalimit automatik të çështjeve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

Ky afat jo vetëm që nuk është arritur, por procesi duket se do të zgjasë edhe më, pasi ngritja e SPAK është parashikuar si një proces kaskadë, i cili nuk mund të fillojë pa emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (DPP)", citojmë raportin e Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, që është asistuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Vallë a dihen të gjitha këto? Duket se politika shqiptare është e interesuar që pas qerthullit të problematikave të përditshme ta lerë mënjanë Reformën dhe për këtë të akuzojë, në mënyrë që kjo gjendje të zgjasë pa fund. Kujtojmë se politika duhej të siguronte mëvetësinë e strukturës së Drejtësisë, standardet, pajisjen me kapacitete adekuate njerëzore, kushtet financiare, teknike dhe logjistike të Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (dy shkallët) dhe SPAK-un, proceset për kushtet e sigurisë dhe aftësive profesionale, përzgjedhjes, emërimit, shkarkimit, kontrollit, mbikëqyrjes, etj., ku në legjislacion parashikohet ndërthurja e veprimtarisë së një sërë aktorësh institucionalë, afatesh dhe procedurash, të cilat e bëjnë të pashmangshëm anashkalimin apo kapërcimin e tyre. Kur i rendit të gjitha këto gjetje të raportit të QSDG, kupton se pse vetingu i politikanëve nuk e gjeti dot rrugën në parlament. Teksa vonesa ka bërë që qytetarët, për shkak të problemeve në Drejtësi, te jenë gjithnjë e më shumë indiferentë me të, ndërsa transparenca të mungojë krejtësisht, ashtu si një mal me vështirësi të veçohet për parametrat e duhura ligjore si p.sh. ato të parashikuara për të garantuar meritokracinë dhe integritetin e punonjësve, të cilët do të rekrutohen në Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit. Në fakt, raporti i realizuar nga një grup ekspertësh të pavarur që synoi një përshkrim të detajuar të proceseve ligjore për krijimin e gjykatave ndaj korrupsionit dhe krimit, por edhe SPAK-u, krijoi një peizazh të këtij momenti të reformës, ndërkohë që gjykatat tona vazhdojnë të japin vendime skandaloze, tashmë të apeluara nga publiku vetëm në emisionet e skandaleve në Tv. Pasi edhe kur ka kaluar më shumë se një vit nga koha e parashikuar për ngritjen e Gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe SPAK-ut, ky proces ende lë shumë për të dëshiruar. "Si rezultat i natyrës komplekse dhe të ndërlidhur të reformës në sistemin e drejtësisë ende nuk janë përmbyllur proceset pararendëse, të cilat do të krijonin kushtet për fillimin e procedurave ligjore të ngritjes së institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar",- citojmë QSDG. Ndërkohë problem mbeten ritmet e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe zgjatja e procesit të rivlerësimit për kandidatët anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, elementë përgjegjës për emërimet e gjyqtarëve në Gjykatat KKKO dhe prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme. Duket se përcaktimi i afateve dhe transparenca për to, do të rikthejë besimin e publikut, por edhe do të krijojë një proces të rregullt ligjor, sa i përket procesit të rivlerësimit, si edhe një kalendar më të mirëpërcaktuar kohor dhe administrativ për zhvillimin e aktivitetit dhe vendimmarrjes së Komisionit. Po deri më atëherë do vijojmë të pyesim njësoj: Pse po vonohet kaq shumë Reforma e Drejtësisë? ("Gazeta Shqiptare")

## HOROSKOPI

### DASHI

Pjesa më e madhe e personave të kësaj shenje nuk kanë gjasa të përfshihen sot në ndonjë çështje të madhe. Megjithatë mund të përfshiheni në ndonjë bisedë të rëndësishme me anëtarë të familjes suaj. Ka gjasa që pas Krishtlindjeve të bëni ndryshime thelbësore.

### DEMI

Shumë persona të kësaj shenje sot do të detyrohen të punojnë në grup. Do t'i bashkoheni përgatitjeve për një shërbim të caktuar. Madje mund të ndihmoni edhe në punët e shtëpisë. Sa i përket lidhjes suaj romantike, nuk do të jetë dita e duhur.

### BINJAKET

Binjakët mund të kuptojnë sot një të vërtetë të rëndësishme. Ndoshta do të kuptoni se marrëdhëniet me njerëzit bazohen në shprehjen e emocioneve. Nëse keni ndërmend t'i shprehni dikujt ndjenjat, sot është dita e duhur.

### GAFORJA

Shumë Gaforre do të shohin një rritje profesionale. Përgatitjet për festën e Krishtlindjeve do t'ju zënë një pjesë të mirë të kohës. Pushimi në mbrëmje do t'ju zgjasë shumë pak dhe nuk do të jetë i mjaftueshëm për t'u ndjerë i relaksuar.

### LUANI

Disa persona të kësaj shenje do të jenë të ngadaltë në çështjet e biznesit. Kjo mund të vijë për shkak të pagjumësisë ose fundjavës së lodhshme që keni kaluar. Bëni mirë t'i kushtoni më shumë vëmendje jetës suaj personale.

### VIRGJERESHA

Do të kaloni një ditë të qetë. Ka gjasa të arrini të gjitha qëllimet për sot pa shumë përpjekje. E vetmja gjë që do t'ju vërë në vështirësi, është dieta ushqimore. Përpiquni të ruani regjimin në kuadër të një shëndeti sa më të mirë.

### PESHORJA

Mos e neglizhoni anën profesionale. Tregohuni të vëmendshëm ndaj çdo detaji. Bëni kujdes me buxhetin, duke qenë se jemi në prag të festave. Rekomandohet të kaloni një mbrëmje shumë të qetë, pa biseda të lodhshme apo ndonjë aktivitet tjetër.

### AKREPI

Do të jeni optimistë për atë çfarë ju pret gjatë vitit të ardhshëm. Një gjendje e tillë mund t'ju vijë pasi ka gjasa të informoheni se së shpejti do t'ju rritet paga. Jashtë pune, do të kaloni një mbrëmje shumë të këndshme.

### SHIGJETARI

Shigjetarët duhet ta përdorin këtë ditë për të forcuar imunitetin. Duhet të bëni gjithçka lidhur me këtë. Ka gjasa që të nisni një lidhje të re romantike. Mbrëmja do të përfundojë më së mirë, pa stres apo lodhje.

### BRICJAPI

Bricjapët mund të humbin sot rastin të takojnë një person të rëndësishëm në jetën e tyre personale. Ndoshta mund të nisë një ndjenjë e re dashurie. Nëse jeni beqarë, duhet ta shfrytëzoni këtë rast, pasi mund të gjeni njeriun tuaj të zemrës.

### UJORI

Ujorët duhet të tregohen më të gatshëm për të zgjidhur disa çështje si në jetën personale ashtu edhe në atë profesionale. Gjatë ditës mund të arrini disa gjëra, por për ta realizuar këtë bëni kujdes me sjelljen dhe ndiqni intuitën.

### PESHQIT

Do të ndiheni shumë të lodhur gjatë ditës së sotme. Mund të përfshiheni në një projekt të madh, i cili do t'ju kërkojë shumë punë. Megjithatë në fund të ditës do të kaloni disa momente të këndshme nën shoqërinë e partnerit/partneres suaj.

## TRAJNERI I PARTIZANIT

### Gega: Duhej të kishim marrë më shumë nga kjo ndeshje

Trajneri i Partizanit, Skënder Gega, ka pohuar pas ndeshjes në Gjirokastër se është i kënaqur me barazimin ndaj Luftëtarit. Ai ka theksuar se Partizani duhet të jetë gati për çdo lloj sfide, për çdo situatë. "Besoj se ndryshime ka, ekipet neve na marrin më seriozisht. Më shqetëson nëse bëjmë 'regres', por për momentin po progresojmë. Duhet të jemi të gatshëm kundër çdo kundërshtari të mundshëm. Unë jam munduar gjatë gjithë kohës të jem korrekt me mediet. Që luajnë fort kundër nesh, më vjen mirë. Forcon skuadrën dhe na bën më të fortë. Sa i takon premiove të kundërshtarit, nuk di gjë. Duhet të jap kontributin aty ku më takon dhe të jem në vendin e duhur. Goli ishte më se i evitueshëm, pasi kishim shumë lojtarë tonët kundër një lojtari të Gjirokastrës. Nuk duhet të mposhteshin 3-4 lojtarë tanë nga një sulmues. Por gjëra që ndodhin dhe ashtu siç erdhi loja, jam i kënaqur. Gjitha ndeshjet i kemi parë seriozisht. Me Gjirokastrën, nuk jam i kënaqur me ekipin për një arsye të thjeshtë: Mund të kishim marrë më shumë".

## TRAJNERI I LUFTËTARIT

### Mezani: Premio nga Kukësi? Di vetëm atë nga presidenti

Trajneri i Luftëtarit, Gentian Mezani ka folur për "Supersport" pas ndeshjes kundër Partizanit, ku u shpreh se pjesën e parë ia kanë falur "Demave të Kuq". Po ashtu, Mezani foli edhe për merkaton e janarit, si dhe për 'premiot e jashtme'. "Është e vërtetë, pjesën e parë e kemi falur lojën, kemi qenë jashtë çdo momenti të lojës. Në pjesën e dytë, jam munduar që të nxjerr pak nga karakteri im dhe tua transmetoj çunave dhe ata ia dolën. Ikja e Rocës dhe pikëpyetja e Shkurtaj është një minus. Është i treti lojtar që largohet nga grupi i vjetshëm dhe normale që do të dobësohemi. Kam biseduar me klubin dhe më kanë ofruar garanci. Unë iu kam dhënë emrat që mund të afrojmë në janar dhe të shohim se çfarë do të ndodhë. Deri më tani, kam marr garanci. Premiot nga palët e treta? Unë nuk di gjë për pjesën e Kukësit. Di që kemi pasur dhe kemi një premio nga presidenti. Na është thënë që është nga presidenti ynë dhe është e mirëpritur, sepse është motivuese për skuadrën. Nëse jep premio çdo ndeshje, akoma më mirë për ne".

Në Gjirokastër mbyllet 1-1, Hoxha dhe Ramadani dalin të dëmtuar nga fusha e lojës

# Partizani ndalet nga Luftëtari, Kukësi ngjitet në vendin e dytë

*Mbyllet pjesa e parë e sezonit, të kuqtë të parët me 37 pikë*



Jeton Selimi

Partizani nuk arriti të shkojë më shumë se një barazim 1-1 në transfertën e vështirë gjirokastrite ndaj Luftëtarit. Të kuqtë gjetën avantazhin në pjesën e parë, fraksion loje të cilin edhe e dominuan, me anë të mesfushorit nga Prizreni, Esat Mala, por Luftëtari riktheu baraspeshën në minutën e 56' me anë të Mersin Ymerajt. Pjesa e dytë ishte shumë më e luftuar, me gjirokastritët që rritën presionin dhe përfitonin nga gabimet e mbrojtjes së kuqe, që ndryshe nga herët e tjera u shfaq edhe më e brishtë, sidomos në krahun e djathtë, ku Ibrahimi vuajti shumë shpërthimet e Xheksonit. Minuta e 60-të e ndeshjes ka sjellë panik në radhët e Partizanit dhe te tifozeria e skuadrës së kuqe. Portieri Alban Hoxha, pas një përplasje me Ymerajn u dëmtua në shpatull dhe u desh të largohej nga fusha e lojës me krahun e lidhur duke përfunduar menjëherë në spitalin e Gjirokastrës. Megjithatë, sipas informacioneve të fundit, duket se është evituar më e keqja që u mendua në fushën e lojës, kur u pa lojtari duke u larguar. Kështu në stadiumin "Luftëtari" u zhvillua një sfidë mjaft interesante, me luftë të fortë sportive dhe mjaft raste shënimi, ku më flagranti ishte ai i Rapos në minutat shtesë, por topi nuk përfundoi në rrjetë. Partizani del me një pikë nga fusha e Gjirokastrës dhe shkon në 37 pikë, 3 më shumë sesa Kukësi i vendit të parë, ndërsa Luftëtari e mbyll pjesën e parë të sezonit në kuotën e 17 pikëve duke ndarë vendin e shtatë me Tiranën.

Sfida tjetër e ditës së djeshme, ajo mes Kukësit dhe Kastriotit, e zhvilluar në stadiumin "Elbasan Arena", përfundoi me fitoren e lehtë 2-0 të skuadrës verilindore. Vesel Limaj në minutën e 3-të dhe Reginaldo në të 36-ën ishin autorët e golave për skuadrën e Cungut, që më pas administroi qetësisht avantazhin, duke kontrolluar lojën dhe duke mos i dhuruar asgjë kundërshtarit. Me këtë fitore, Kukësi ngjitet në vendin e dytë të renditjes me 34 pikë, vetëm 3 më pak se Partizani kryesues dhe një më tepër se Teuta që e mbyll gjysmën e parë të sezonit në vendin e tretë. Nga ana tjetër, Kastrioti mbetet në vendin e fundit me 10 pikë, 5 më pas se Kamza e parafundit, ndërsa skuadra e Gjokës, bashkë me Luftëtarin dhe Tiranën, duket se do të luftojnë deri në fund për të mbijetuar në Superiore.



**SUPERLIGA**

*TË PREMTEN*

| | |
|---|---|
| Kamza - Skënderbeu | **1-0** |
| Tirana - Flamurtari | **1-0** |

*TË SHTUNËN*

| | |
|---|---|
| Teuta - Laçi | **1-1** |

*TË DIELËN*

| | |
|---|---|
| Kukësi - Kastrioti | **2-0** |
| Luftëtari - Partizani | **1-1** |

*RENDITJA*

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Partizani | 18 | 37 |
| Kukësi | 18 | 34 |
| Teuta | 18 | 33 |
| Skënderbeu | 18 | 31 |
| Laçi | 18 | 30 |
| Flamurtari | 18 | 28 |
| Luftëtari | 18 | 17 |
| Tirana | 18 | 17 |
| Kamza | 18 | 15 |
| Kastrioti | 18 | 10 |

## Trajneri i Kastriotit dorëhiqet

### Nica akuzon: Lojtarë tekanjozë, i pësojnë golat kur duan!

Trajneri Stavri Nica ka deklaruar largimin nga stoli i Kastriotit, duke thënë se nuk mund të vazhdojë më me këtë mënyrë pune. Ai ka akuzuar lojtarët për mosimpenjim, duke vënë gishtin në një plagë të vjetër të futbollit shqiptar. "Lojtarët nuk janë të impenjuar, e shoh nga mënyra të stërviten. Po shoh një ftohje, një mosimpenjim, mosorganizim në kushte e lojës dhe stërvitjes. Janë shumë detaje që më të detyrojnë të mos jem pjesë e kësaj mënyre loje, e kësaj skuadre. Nuk e kam në karakter të sillet skuadra si të dojë, t'i pësojë golat kur të dijë dhe të impenjohet kur të dojë në kushte loje. Jam shumë i mërzitur për këtë mënyrë loje. Nuk shoh perspektivë, e mbyll, nuk sakrifikoj veten për lojtarë tekanjozë. Te klubet e tjera edhe këtu unë gjithmonë ngul këmbë, sepse më vjen keq për futbollin. Niveli i ulët dhe sigurisht nuk funksionon ana profesionale. Në momentin që nuk funksionon ana profesionale, asgjë nuk është siç duhet dhe unë se duroj dot. Nuk jam trajner për të marrë një rrogë dhe për të mbyllur sytë. Më mirë rri në fukarallëkun tim sesa kështu. Të gjithë lojtarët këtu kanë nivel të ulët. Kam lojtarë që nuk dalin në stërvitje se më tha: 'Po përtoj'. Imagjinoni ku po vijmë të marrim rrogën. Një nivel diletant! Kudo që jemi, si unë brenda futbollit, si ju në studio, duhet të ngremë zërin dhe të bëjmë pjesën tonë për futbollin shqiptar. Absolutisht, nuk kemi klube të mëdha! Na gënjen mëndja. Kemi nivel shumë të ulët dhe nëse vazhdojmë të gënjejmë veten kështu, nuk do të ecet asnjëherë përpara," deklaroi Stavri Nica në përfundim të ndeshjes.

## TRAJNERI I KUKËSIT

### Cungu: Ekipi po tregon rritje pas çdo jave

Trajneri i Kukësit, Armando Cungu, ka deklaruar pas fitores me Kastriotin se e kishte menduar shumë të vështirë këtë ndeshje, pasi të tijtë kishin presionin e rezultatit. Ai ka falënderuar lojtarët për punën e bërë dhe rezultatet që kanë arritur. "Ekipi nga java në javë po tregon rritje, si në lojë, ashtu dhe rezultate. Për mua si trajner, ishte ndeshja më e vështirë. Luajtëm kundër ekipit të fundit të tabelës dhe mund të na dënonte euforia pas Korçës dhe Partizanit. Kemi punuar shumë mirë, si në fillim të sezonit, si tani. Kemi bërë një progres shumë të madh dhe që ditën e parë të kampionatit, kemi bërë ndeshje më të mira se kundërshtarët. Por thjesht nuk kemi pas rezultate, por tani po na vijnë dhe rezultatet dhe dua të falënderoj djemtë".


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al